



PROGRAMI NXITËS PËR LINJA TE REJA I AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË PRISHTINËS

**nga
DEPARTAMENTI KOMERCIAL**

**2010
Versioni 2**

NENI 1: SYNIMI

Ky program synon vendosjen e afateve dhe kushteve për programin nxitës për linja të reja të ANP-së, që i nënshtrohet sistemit të çmimeve në zbatim.

NENI 2: NXITJA PËR ZHVILLIMIN E LINJAVE TË REJA

Ky program nxitës ka për qëllim nxitjen e linjave në vende të cilat aktualisht nuk shërbehen drejtpërdrejt nga aeroporti ynë. Ne jemi të vetëdijshëm që kompanitë ajrore pranojnë veçanërisht reziqe të mëdha kur të vendosin mbi linjat e reja dhe që ne përfitojmë nga linjat e reja të suksesshme. Prandaj, ne e ndajmë rrezikun financiar përmes kësaj nxitje.

Kushti i posaçëm

1. Lidhja ajrore komerciale me një aeroport, që nuk është shërbyer, në 12 muajt e menjëhershëm para aplikimit, me fluturime pa ndërprerje në aeroport.
2. Për qëllime të këtij programi, fluturimet e operuara nga aeroplanët që kanë peshë maksimale të bartjes më të vogël se 20.000 kg (njëzet mijë kilogram) janë të përjashtuara.
3. Linja duhet të operohet non-stop, p.sh. pa transfere përmes aeroporteve tjera. Linja me ndalesë teknike, ku udhëtarët komercial nuk e lëshojnë apo nuk hipin në aeroplan, konsiderohet si linjë non-stop.
4. Kompania ajrore duhet të përmbush kërkesat mbi frekuencën për destinime të reja, së paku dy ditë në javë në sezonin sipas IATA-s.


Skema nxitëse

1) Nëse një kompani ajrore e fut një linjë për në një destinim të ri të shërbyer nga ANP, kushtet dhe çmimet në vijim gjejnë zbatim:

NXITJA PËR LINJË TË RE			
Viti	1	2	3
Çmimi për aterrim / nisje	100 %	75 %	50%

2) Programi nxitës për linja të reja është valid duke filluar nga dita e parë e operimit të kompanisë ajrore në linjën e re. Nëse një kompani tjetër fillon operimet në linjën e re që ka filluar të operohet sipas programit nxitës për linja të reja, kompania e re fiton të drejtën për kushte të njëjta si kompania e parë por vetëm në periudhën e mbetur të programit nxitës.

Shembull i llogaritjes së programit për kompanitë tjera



NENI 3: PËRFITUESIT

1. Programi stimulues është drejtuar kah të gjitha kompanitë ajrore komerciale që bëjnë udhëtarë dhe të cilat operojnë apo kanë për qëllim të fillojnë operimet në ANP dhe të atyre që përmbushin të gjitha kërkesat dhe kriteret e përshkruara në këtë Program.

NENI 4: KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. ANP ka të drejtën në moszbatimin e programit të nxitjes për linja të reja nëse kompania ajrore nuk i ndjek kushtet e përcaktuara.
2. ANP ka të drejtën që të bëjë vendimin përfundimtar nëse një kompani ajrore është e pranueshme apo jo për nxitje.
3. ANP e ruan të drejtën që të rishikon dhe ndryshon skemën e nxitjes, kurdo qoftë në pajtueshmëri me praktikën ndërkombëtare dhe ligjet në fuqi në Kosovë.
4. Stimulimet që janë për t'u dhënë sipas kushteve të këtij programi nuk duhet të implikojnë, në cilën do kohë, zbritjet e drejtpërdrejta në shumat e paguara dhe të ngarkuara nga ANP apo të marrin formën e pagesave të kreditit.
5. Lidhjet e reja dhe planifikimet e tyre të përfshira në programin operues duhet t'i kenë sllotet e tyre të miratuara nga Koordinatorin e sllotave.
6. Pajisja e përdorur nga kompania ajrore që aplikon duhet të klasifikohet në Kapitullin 3 apo më lart, në përputhje me përcaktimet dhe specifikimet të krijuara në Shtojcën 16 të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO).

7. Linjat e përfshira në detyrat e shërbimit publik janë të përjashtuara nga ky program.
8. Formulari i trafikut është dokumenti që mbështet tërë procesin e këtij programi, në veçanti për qëllime të monitorimit të kompanisë ajrore dhe certifikimit të numrit të udhëtarëve të cilët barten në të vërtetë.
9. Ky program nxitës është i ri dhe nëse ngrihet ndonjë paqartësi lidhur me përlogaritjet, ANP e ruan të drejtën për të zhvilluar rregullore shtesë për t'u siguruar që të arrihet qëllimi i përgjithshëm i këtij programi.

NENI 5: VENDIMI PËRFUNDIMTAR MBI DHËNIEN E STIMULIMIT

Vendimi përfundimtar lidhur me atë nëse një kompani ajrore është e pranueshme për këtë program nxitës është përgjegjësi e vetme e ANP. ANP e ruan të drejtën për të refuzuar apo pezulluar, në çdo moment, dhënie e stimulimit për anashkalim të interesit publik dhe në rastet vijuese:

- Kur kompania ajrore nuk siguron pagesë të menjëhershme të ndonjë fature të papaguar ndaj ANP-së;
- Kur kapaciteti i ANP-së të jetë arritur apo është në pikën e ngopjes ,atëherë aeroporti pezullon programin valid nxitës por jo edhe për kompanitë që e kanë të aprovuar programin nxitës sipas kontratës.

NENI 6: VENDIMI

1. ANP do të analizojë aplikimin e dorëzuar dhe do të arrijë deri te vendimi përfundimtar përbrenda një periudhe prej 15 ditëve të punës pasi që t'i ketë pranuar aplikimet.
2. Vendimi final do t'i njoftohet aplikuesit përmes postës apo faksit të regjistruar, me konfirmim pas pranimit, zyrës qendrore të aplikuesit apo në adresën e cekur në formularin e aplikimit.
3. Nëse aplikimi dhe plani i tij i fluturimeve miratohen, njoftimi nën numrin 2 do të përfshin një vlerësim fillestar të shumës stimuluese që duhet të jepet.
4. Pranimi i vendimit përfundimtar të ANP-së sipas kushteve të këtij neni dhe formulari i aplikimit e bëjnë formal pranimin e dyanshëm të kushteve të përcaktuara në këtë program.
5. Marrëveshja (Vendimi) përfundimtar për programin nxitës do të bëhet në formë të kontratës në mes të ANP-së dhe kompanisë aplikuese.

NENI 7: PAGESA E NXITJES

1. Nxitja e përllogaritur dhe e miratuar nën kushtet të paguhet përmes transferit bankar, bazuar në një njoftim debiti që duhet të lëshohet nga kompania ajrore në fund të periudhës nxitëse, apo me çfarë do mënyre tjetër të dakorduar nga të dyja palët.
2. Pagesa e nxitjes gjithmonë do të varet nga sanksionimi paraprak, që kompania ajrore është në pajtim me operimet e planifikuara nga formulari i aplikimit dhe të miratuar nga ANP, dhe gjithashtu që së paku 80% nga sllotete paraprake të miratuara për periudhën në fjalë faktikisht edhe janë shfrytëzuar.

NENI 8: KUSHTET SPECIALE

1. Nëse aplikimi do të miratohet, palët do të nënshkruajnë marrëveshjen me shkrim e cila rregullon kushtet specifike të nxitjes dhe që do të përfshin së paku informatën vijuese:
 - Kohëzgjatja e aplikimit;
 - Plani operativ;
 - Vlerësimi fillestar i shumës së nxitjes, përllogaritur në përputhje me planin e propozuar operativ;
 - Metoda dhe data përmbyllëse për dhënien e nxitjes.
2. Cilat do ndryshime të kushteve fillestare të vendosura për dhënies, nxitja duhet që të ndryshohet me kohë dhe të bëhet pjesë integrale e dokumentit të përmendur në numrin 1.

NENI 9: MBIKËQYRJA

1. Të gjitha planet nxitëse i nënshtrohen auditimeve hetuese për të siguruar plotësimin e kërkesave, të përcaktuara në nenin paraprak, që janë përgjegjësi e ANP.
2. Programi do të monitorohet dhe kontrollohet bazuar në planin e detajuar që përvijon një varg operimesh të mbuluara nga nxitja, si dhe në formularët e trafikut të përmendura në nenin 4, numri 9.

NENI 10: SANKSIONET

Cila do kompani ajrore që manipulon me programin e vet të fluturimit për secilën periudhë, vet apo si pjesë e përpjekjeve të kombinuara me kompanitë tjera ajrore, në mënyrë që të kualifikohet për programin nxitës, do të diskualifikohet.

NENI 11: VLEFSHMËRIA

Programi është rregulluar ekskluzivisht nga ligji i Kosovës dhe është në fuqi nga 01 qershor 2010 deri më 31 maj 2011, përveç nëse njoftohet ndryshe nga ana e ANP-së.

Kompanitë Ajrore mund të aplikojnë për të qenë pjesë e këtij programi brenda periudhës një vjeçare prej 01 qershorit 2010 deri me 31 maj 2011